



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:044319

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05466064

KF.nr.61/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri në kontestin tregtar administrativ të paditësit “AS Alberti” SH.P.K. me seli në Çagllavicë-Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” në Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, vlerë kontesti 14,600.49€, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, G.B. nga Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, dhe në mungesë të palës paditëse, me datë 14.03.2024 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit AS Alberti SH.P.K. me seli në Çagllavicë-Prishtinë.
- II. ANULOHET aktvendimi me nr.06.2/909, 980 i datës 20.01.2019 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit AS Alberti SH.P.K. me seli në Çagllavicë-Prishtinë, t’ia kthej mjetet e paguara më tepër dhe atë në emër të taksës doganore 10%, shumën prej 4,899.33€ dhe të TVSH-së 9,700.67€ e që në total arrin shumën e përgjithshme prej 14,600.49€, (katërmbëdhjetë/mijë/e/gjashtëqind/euro/e/dyzet /e/nëntë/cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me R49224/19.10.2016, R49229/19.10.2016, R49226/19.10.2016, R49232/19.10.2016, R49233/19.10.2016, R49236/19.10.2016, R50559/19.10.2016, R50546/27.10.2016, R50568/27.10.2016, R50553/27.10.2016, R50542/27.10.2016, R54676/18.11.2016, R54640/18.11.2013, , R54626/18.11.2016, R54664/18.11.2016, R54700/18.11.2013, R57914/05.12.2016,

R57616/03.12.2016, R57602/03.12.2016, R57643/03.12.2016, R57621/03.12.2016, R57640/03.12.2016, R57608/03.12.2016, R57633/03.12.2016 dhe R57591/03.12.2016 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtina, me kamatë ligjore prej 8% dhe atë nga data e ushtrimit të padisë 25.03.2020 e deri në kthimin e plotë, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “AS Alberti” SH.P.K., me seli në Çagllavicë përmes përfaqësuesit të autorizuar me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 25.03.2020, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë ndaj vendimit nr.06.2/909,980 të datës 20.01.2020. Në seancën e shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaroi se: Mbetem në tërësi pranë kërkesë padisë, pranë të gjitha pretendimeve të cekura si në padi si dhe pranë të gjitha deklarimeve nga seancat e kaluara. E kemi pranuar ekspertizën dhe plotësimin e saj të cilën e pranojmë pa vërejtje sipas detyrave të caktuara sipas vendimit të gjykatës dhe vërejtjeve nga seanca e kaluar. Edhe pas deklarimit të ekspertit rezervojmë të drejtën e precizimit të kërkesë padisë duke kërkuar edhe kamatën prej 8% në vit, të llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuara. Aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Në seancën e shqyrtimit kryesor përfaqësuesja e autorizuar e paditësit deklaroi se: Të bëjë precizimin e kërkesë padisë dhe atë, i propozoj gjykatës që të aprovojë si të bazuar padinë dhe kërkesë padinë dhe kërkesë padinë e paditësit, ta anuloj aktvendimin e kontestuar dhe të obligohet e paditura që paditësit t’ia kthejë shumën e përgjithshme prej 14,600.49€, të paguara më tepër si rrjedhojë e rivlerësimit të mallit, përkatësisht për taksën doganore 4,899.33€, dhe të TVSH-së 9,700.67€, e të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi 06.2/909,980 të datës 20.01.2019, përgjigja në padi e datës 09.06.2021, ankesa e ushtruar nga ATK, raporti i kontrollit i datës 19.04.2016, deklaratat EXA, faturat e DUD-ave kontestues, proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, CMR, librezat e veturave kontestuese, DUD-at IM7 57923, 5738, 57929, 57940, 54676, 54626, 52664, 54700, 57591, 57640, 57643, 57621, 57608, 57597, 57633, 57602, 57923, 57904, 54630, 57925, 54691, pagesat bankare ndërkombëtare së bashku me kartelat e kontos për periudhën kontestuese, ekspertiza financiare e datës 18.07.2023, aktvendimi 06.02/909,980 i datës 23.12.2016, plotësim ekspertiza financiare e datës 12.02.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në këtë procedurë gjyqësore të kontestit tregtar administrativ në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se subjekti AS Alberti SH.P.K. këtu paditësi, përmes DUD-ave nr.R49224/19.10.2016, R49229/19.10.2016, R49226/19.10.2016, R49232/19.10.2016, R49233/19.10.2016, R49236/19.10.2016, R50559/19.10.2016, R50546/27.10.2016, R50568/27.10.2016, R50553/27.10.2016, R50542/27.10.2016, R54676/18.11.2016, R54640/18.11.2013, R54626/18.11.2016, R54664/18.11.2016, R54700/18.11.2013, R57914/05.12.2016, R57616/03.12.2016, R57602/03.12.2016, R57643/03.12.2016, R57621/03.12.2016, R57640/03.12.2016, R57608/03.12.2016, R57633/03.12.2016 dhe R57591/03.12.2016 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtina ka deklaruar për zhdoganim mallin lëndor, sipas dokumentacionit përcjellës të mallit. Po ashtu nuk ishte kontestuese as fakti tjetër që e paditura e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit nga paditësi, e ku si rezultat i kësaj përmes proceseve mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, ka caktuar bazë të re doganore për këtë mall, duke u bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit nga neni 35, i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109. Nuk është kontestues as fakti se paditësi ka ushtruar ankesë në Doganën e Kosovës e për të cilën ankesë e paditura fillimisht me datë 23.12.2016, ka sjell aktvendimin nr.06.2/909, pastaj në rivendosje edhe Aktvendimin 06.2/909, 980 të datës 20.01.2019, me të cilin ka refuzuar ankesën e këtu paditësit, e ndaj të cilin aktvendim

paditësi me këtë padi ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se deklaratat unike doganore IM7 si më lartë janë shkarkuar me deklaratat unike doganore IM4.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Sektori i Pranimit qëndron-Dogana e Kosovës ka refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë AS Alberti SH.P.K me seli në Çagllavicë, për rishqyrtimin e vendimeve nr.R49224/19.10.2016, R49229/19.10.2016, R49226/19.10.2016, R49232/19.10.2016, R49233/19.10.2016, R49236/19.10.2016, R50559/19.10.2016, R50546/27.10.2016, R50568/27.10.2016, R50553/27.10.2016, R50542/27.10.2016, R54676/18.11.2016, R54640/18.11.2013, R54626/18.11.2016, R54664/18.11.2016, R54700/18.11.2013, R57914/05.12.2016, R57616/03.12.2016, R57602/03.12.2016, R57643/03.12.2016, R57621/03.12.2016, R57640/03.12.2016, R57608/03.12.2016, R57633/03.12.2016 dhe R57591/03.12.2016 të ZBD Prishtinë, sipas të cilit vendim ka konstatuar se Zyra e pranimit qëndror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar me qellim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDA-së, po ashtu e paditura në vendimin kontestues deklaron se subjekti këtu paditësi nuk i ka bashkangjitur dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar vlerën e mallit përcjellës i mallrave lëndor për DUD-at kontestues është i pamjaftueshëm, pasi që mungon kontratën e shitblerjes për mallin lëndor kontestues, andaj Zyra Doganore ka vepruar drejtë kur mallin lëndor e ka vlerësuar komfor metodës së gjashtë të vlerësimit, neni 35 të KDA-së, duke u bazuar në të dhënat e disponueshme katalogu Schwacke List.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit të kësaj gjykate ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar administrativ me ekspertin financiar R.S. e i cili ka pasur për detyra sikurse ne aktvendimin përkatës.

Eksperti financiar në ekspertizën financiare të datës 18.07.2023, dhe në plotësim ekspertizat financiare të datës 12.02.2024 ka konstatuar se diferenca e mjeteve të paguara më tepër për shkak të rivlerësimit të DUD-ave kontestues si në aktvendimin të caktimit të ekspertit financiar

është taksë doganore e paguar më tepër në shumë prej 4,899.33€ dhe TVSH e paguar më tepër në shumë prej 9,700.67€, e të gjitha së bashku në shumën prej 14,600.49 euro, se janë harmonizuar shumat e transaksionit bankar ndërkombëtar në raport me faturat përcjellëse të mallit të deklaruar me DUD-at kontestues, është vërtetuar statusi bankar ndërkombëtar i pagesës përmes fletëpagesave, që kryesisht janë bërë nga dhe në Raiffesen Bank, tutje nga të gjitha faturat dhe blerjet me DUD-at kontestues të njëjtat janë shkarkuar- shitur në tregun vendor e që i janë nënshtruar regjimit doganor IM4 në të cilin janë paguar obligimet doganore, përveç dy veturave të cilat janë rieksporuar dhe janë shkarkuar po ashtu me IM7 si: R 55236 dhe R 58570 si në tabelën e paraqitur nr.3 dhe për të njëjtit nuk është paguar taksa doganore e as TVSH, për çka nuk janë përfshirë si diferencë në përlllogaritjen e kësaj ekspertize.

Gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe ia dha besimin e plotë ekspertizës financiare dhe plotësimin të saj të punuara nga eksperti R.S., ngase ekspertiza dhe plotësimet e saj i përmbajnë elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale, dhe kanë arsyetime të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoj si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë kontest tregtar administrativ, si dhe të njëjtat janë në harmoni me legjislacionin doganor të aplikueshëm.

Eksperti financiar në seancën e datës 14.03.2024 ka sqaruar se: Sipas detyrave të dhëna nga Gjykata në seancën e fundit, ne kemi bërë plotësimet e ekspertizës duke shtuar si bazë doganore edhe shpenzimet e transportit dhe shpenzimet e tjera bartëse. Si bazë për llogaritjen e detyrimeve doganore dhe diferencës së vlerësuar nga dogana. Ashtu që sipas ekspertizës, vlera e cila do të detyrohej nga pala e paditur për palën paditëse në total është 14,606.49€.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-ave nr.R49224/19.10.2016, R49229/19.10.2016, R49226/19.10.2016, R49232/19.10.2016, R49233/19.10.2016, R49236/19.10.2016, R50559/19.10.2016, R50546/27.10.2016, R50568/27.10.2016, R50553/27.10.2016, R50542/27.10.2016, R54676/18.11.2016, R54640/18.11.2013, R54626/18.11.2016, R54664/18.11.2016, R54700/18.11.2013, R57914/05.12.2016, R57616/03.12.2016, R57602/03.12.2016, R57643/03.12.2016, R57621/03.12.2016, R57640/03.12.2016, R57608/03.12.2016, R57633/03.12.2016 dhe R57591/03.12.2016 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtina dhe në këtë mënyrë

të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 14,606.49 euro, mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata konsideron se paditura do të mund ta mbështetet një konstatim të këtillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues, i ka paguar eksportuesit mbi çmimin neto të faturave të mallit, ku vlera e mallit të faturuar nga eksportuesi është paguar nga paditësi përmes transaksioneve bankare siç janë konstatuar në ekspertizë financiare dhe plotësime të tyre.

Gjykata vlerëson se nuk përbën shkak ligjor për rivlerësim të mallit dhe caktim të bazës së re doganore për paditësin, fakti që e paditura disponon me të dhëna nga zhdoganimet e mëhershme dhe nga dosja e vlerës, në bazë të të cilës vlera e mallit është dukshëm më e lartë se vlera e deklaruar nga subjekti, sepse me dispozitën ligjore të nenit 31 par.1 të KDAK-së nuk thuhet që vlera doganore e mallrave të importuar duhet të jetë e njëjtë me vlerën e mallrave të marra nga zhdoganimet e mëhershme dhe Dosja e Vlerës, por aty përkundrazi shprehimisht përcaktohet se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është parashikuar që *“Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”*.

Sipas nenit 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, është parashikuar që, dokumenti që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*.

Arsyetimi i të paditurës i dhënë në vendimi e kontestuar se në shkresat e lëndës ka munguar kontrata e shitblerjes prandaj Dogana e Kosovës e ka të pamundur të pranoj vlerën e transaksionit të subjektit në procedurë, për Gjykatën nuk është i bazuar, sepse me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109 dhe as me dispozitat e UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave, nuk parashihet që kontrata është dokument i cili duhet bashkangjitur deklaratës doganore, për vendosje në qarkullim të lirë të mallit të importuar dhe për tu aplikuar metoda e parë e vlerësimit sipas nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Prandaj nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata përfundimisht cilëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, komfor nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Si rezultat i kësaj, gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 292 pika b, të KDAK-së nr.03/L-109 dhe nenit 67 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, miratoj kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t'i kthej shumën prej 14,600.49€, të paguar më tepër për shkak të rivlerësimit të pa drejtë mallit, në emër të detyrimeve importuese, për mallin e zhdoganuar përmes DUD-ve , nr.R49224/19.10.2016, R49229/19.10.2016, R49226/19.10.2016, R49232/19.10.2016, R49233/19.10.2016, R49236/19.10.2016, R50559/19.10.2016, R50546/27.10.2016, R50568/27.10.2016, R50553/27.10.2016, R50542/27.10.2016, R54676/18.11.2016, R54640/18.11.2013, R54626/18.11.2016, R54664/18.11.2016, R54700/18.11.2013, R57914/05.12.2016, R57616/03.12.2016, R57602/03.12.2016, R57643/03.12.2016, R57621/03.12.2016, R57640/03.12.2016, R57608/03.12.2016, R57633/03.12.2016 dhe R57591/03.12.2016 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Interevropa.

Gjykata konstaton se shuma e paguar më tepër nga paditësi prej 14,600.97€, në emër të detyrimeve doganore, si pasoj e vlerësimit të mallit nga e paditura u konstatua nga plotësim ekspertizës financiare të datës 12.02.2024 të punuar nga eksperti financiar R.S..

Sa i përket kamatës gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, duke pasur parasysh dispozitën e nenit 292 pika b) (i), të KDAK-së nr.03/L-109, ku parashihet *“Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: Të Apeluesit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme”*

dhe dispozitat ligjore të nenit 170 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku thuhet se “Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit” dhe nenit 382 paragrafi 2 të këtij ligji ku thuhet se “Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”, ndërsa si datë morri ditën e ushtrimit të padisë në gjykatë 25.03.2020.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë/Departamenti Fiskal
KF.nr.61/22, datë 14.03.2024

Zyrtare Ligjore
Amire JAHIRI

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.